

Promovim Libri
5/ 11/ 2024 - Ora 11:00

“MALET E GJIGANTËVE”

Realizuar:



Nën kujdesin dhe mbështetjen
financiare të

Z. Avni PONARI

Drejtore i Përgjithshëm,
SIGAL UNIQA AL-KS-MKV



Përkthyer nga

Mal BERISHA

Ambasador

Me pjesëmarrjen e:



Dr. David Shankland
Drejtore i Institutit Mbretëror
Antropologjik Britanishë së
Madhe dhe Irlandës



**Prof. Ass. Dr.
Gentiana Kera**
Universiteti i Tiranës



NdreK Gjini
Shkrimtar



Fjoralba PONARI
Prezantuese televizive
dhe Ambasadore Brand-i

Të ftuar shkencëtarë, historianë, njerëz të letrave shqipe
nga të gjithë trevat shqipfolëse



Studim racor dhe kulturor kushtuar Gegëve të Shqipërisë së Veriut, shkruar nga antropologu amerikan Carleton S. Coon, përkthyer nga Mal Berisha.

Vendi: Hotel Marriot – Tiranë

Data: 5 nëntor 2024


Ora: 11:00 – 15:00

Veprimtaria do të shoqërohet me një drekë për të gjithë pjesëmarrësit në Restorantin e Hotel Marriot-it.

PROGRAMI I PROMOVIMIT TË LIBRIT

"MALET E GJIGANTËVE"

Ky aktivitet e tejkalon thjesht promovimin e librit "Malet e Gjigantëve" të Carleton S. Coon. Ai përfaqëson një angazhim të veçantë në vlerësimin e trashëgimisë kombëtare, një kauzë e përkrahur nga z. Avni Ponari i cili ka ngritur platformën dixhitale të parë dhe të vetme "Dëgjoni libra në gjuhën shqipe" në:



Si dhe sponsorizimin e botimit të dhjetëra librave të autorëve të ndryshëm, krijimit të Orkestres së Harqeve SIGAL dhe shumë kontributeve të tjera për kulturën shqiptare.

Shënim: Hyrja bëhet vetëm me ftesa të personalizuar, të konfirmuara që më parë dhe të patransferueshme.

Z. Avni Ponari

Rëndësia e përkthimit në gjuhën shqipe të librit "Malet e Gjigantëve" dhe mbështetjes së kulturës tonë kombëtare.

Z. Mal Berisha

"Malet e Gjigantëve", kushtuar Gegëve të Veriut të Shqipërisë, midis 25 veprave të Prof. Carleton S. Coon.

Z. Ndrek Gjini

Vendi i librit "Malet e Gjigantëve" brenda veprës së Prof. Coon, "Racat e Evropës".


Prof. asoc. Dr. Gentiana Kera

"Rëndësia e librit 'Malet e Gjigantëve' për studimet antropologjike dhe për njohjen e shoqërisë shqiptare të veriut të Shqipërisë gjatë gjysmës së parë të shekullit XX."

Dr. David Shankland

Rëndësia e kërkimeve antropologjike të Miss Edith Durham dhe Margaret Hasluck në Shqipëri, të cilave Prof. Coon iu referohet në librin e tij "Malet e Gjigantëve".

Moderatore: Znj. Fjoralba Ponari



Dr. Carleton S. Coon

Dr. Carleton S. Coon lindi më 23 qershor 1904. Ai konsiderohet një nga antropologët më të rëndësishëm amerikanë të shekullit të 20-të. Në vitin 1925 kur ishte vetëm 24 - vjeç ai u diplomua për antropologji me Medalje të Artë në Universitetin e Harvard - it. Në vitin 1928, ai u emërua profesor i antropologjisë pranë këtij Universiteti. Coon ka shërbyer si dekan i Fakultetit të Antropologjisë në Harvard dhe për një kohë të gjatë ka qenë President i Shoqatës së Antropologëve të Shteteve të Bashkuara. Në vitin 1948, ai u bë kurator i etnologjisë në Muzeun e Universitetit të Pensilvanisë dhe njëherazi profesor po në atë universitet.

Dr. Coon është shumë i rëndësishëm për ne shqiptarët, pasi përveç veprave të tij të çmuara, ai shkroi edhe librin "Malet e Gjigantëve", një studim racor dhe kulturor për Gegët e Shqipërisë

së Veriut. Ai është i pari dhe pothuajse i vetmi deri më sot që ka ndërmarrrë një ekspeditë të tillë kaq të gjatë dhe pa ndërprerje, gjatë viteve 1929-1930, dhe kaq të shtrirë në terren - në Malet e Gegnisë. Ai ka jetuar në terren, ka matur trupat e shqiptarëve me dorën e tij, ka analizuar të dhënat dhe ka argumentuar praninë Iliro - Dinarike të shqiptarëve Gegë në veri të Shqipërisë. Si antropolog i pavarur, ai dha mendimin e tij pa asnjë ndikim ideologjik. Studime të ngjashme të kryera nga antropologët shqiptarë gjatë viteve të diktaturës nuk kanë mundur të përmendin emrin dhe veprën e Prof. Coon në punimet e tyre.

Studimi i matjeve antropologjike prej 1.067 shqiptarësh, i realizuar nga Prof. Coon, as nuk është sfiduar dhe as nuk është përsëritur më që nga viti 1930, në formë, në masë apo dhe shtrirje të tillë.



Z. Ponari është fitues i shumë çmimeve dhe vlerësimeve kombëtare dhe ndërkombëtare

- › "The Order of the Rising Sun, Gold Rays with Neck Ribbon" nga Perandori Japonez për kontributet e tij të jashtëzakonshme për promovimin e shkëmbimeve dhe forcimin e mëtejshëm të marrëdhënieve miqësore ndërmjet Shqipërisë dhe Japonisë, dhe më herët.
- › "Dekorata e Lartë e Nderit" nga Presidenti i Austrisë Alexander Van der Bellen (Një nga Dekoratat më të larta e akorduar nga Republika e Austrisë).
- › "Kavalier i Paqes" nga 'Qendra Ndërkombëtare për Paqen mes Njerëzve'
- › "Certifikatën e Mirënjohjes" nga qeveria japoneze, në cilësinë e tij si 'Konsull i Përgjithshëm Nderi i Japonisë'.
- › "Drejtuesi më i mirë i kompanisë së sigurimeve në Shqipëri dhe në Evropën Juglindore për vitin 2021/22", nga "Finance Central Europe".
- › "20 CEO me Performancën më të Mirë në vitin 2020" nga Insight Success Media Tech
- › "Njeriu i Vitit" nga 'Instituti Amerikan Biografik'.
- › "Menaxher i Vitit" nga 'Komiteti i Sokratit të Oksfordit', në Mbretërinë e Bashkuar.
- › "Grand Excellence 2023", nga Bordi i "Albanian Excellence".

AVNI PONARI

Z. Avni Ponari është themelues dhe Drejtor i Përgjithshëm i SIGAL UNIQA Group Austria, Kryetar i Bordit të Drejtorëve të SIGAL Life UNIQA Group Austria Kosovë; Anëtar i Bordit të Drejtorëve të SIGAL UNIQA Group Austria Kosovë; President i Bordit Mbikëqyrës të UNIQA A.D dhe UNIQA Life A.D në Maqedoninë e Veriut.

Z. Ponari mban postin e Presidentit të të tria kompanive të Grupit SIGAL UNIQA në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut që prej 22 shkurtit 1999, sot kompanitë lidere, pararojë dhe më të suksesshme në industrinë vendase dhe rajonale të sigurimeve.

Z. Ponari është një ndër sipërmarrësit më të suksesshëm në vend, sipërmarrjet e të cilit e kanë kthyer atë, jo vetëm në një lider në fushën e biznesit, por dhe me ndikim pozitiv në zhvillimet e jetës ekonomike, sociale, kulturore dhe sportive të vendit.

Ai është një nga investitorët më të rëndësishëm me impakt të konsiderueshëm në ekonomi dhe drejtues i suksesshëm i një sërë sipërmarrjesh të tjera në fushën e turizmit, dhe sipërmarrjeve/bizneseve financiare. Z.Ponari është zotëron ekskluzivitetin për Shqipërinë edhe të dy koncesionarëve, "Toyota" dhe "Peugeot".

Për më tepër, prej vitit 2009 Z. Ponari është Konsull i Përgjithshëm Nderi i Japonisë në Shqipëri, Kryetar Bordi dhe President i Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë Shqipëri - Japoni; Anëtar i disa prej Dhomave më të rëndësishme të Tregtisë dhe Industrisë ndërmjet Shqipërisë dhe vendeve të tjera dhe President i Federatës Shqiptare të Basketbollit.

Ai është diplomuar në Marinë në Universitetin e Vlorës dhe në Fakultetin e Drejtësisë në Universitetin e Tiranës. Z. Ponari ka marrë gjithashtu një sërë kualifikimesh dhe trajnimesh të ndryshme brenda dhe jashtë vendit, nga kompanitë më të njohura të sigurimeve dhe risigurimeve në botë.



Mal Berisha

Mal Berisha, Ish Ambasador i Republikës së Shqipërisë në Mbretërinë e Bashkuar, ka diplomuar në Akademinë e Arteve të Shqipërisë në vitin 1976 dhe ka punuar si punonjës i artit dhe kulturës në rrethin e Krujës nga viti 1976 deri në 1992. Ai ka shërbyer si diplomat në Konsullatën Shqiptare në Stamboll (1992-1997) dhe ka qenë aktivist për çështjen e Kosovës me Ligën Qytetare Shqiptaro-Amerikane dhe Federatën Pan-Shqiptare të Amerikës, VATRA në New York. Gjithashtu, ka punuar si staf ndërkombëtar në Misionin e Kombeve të Bashkuara UNMIK në Kosovë (2000-2009). Ai ka ligjëruar në YIVO Institute në New York, si dhe në universitete në Londër, Tiranë, Korçë, Harvard-Boston, Gjenevë, Vjenë, Shkup, Prishtinë, mbi temën e Pushtetit të Butë të Diplomacisë dhe promovimit të Shqipërisë në botë. Ai ka vendosur bustet e Skënderbeut në Londër në (2012), në Munxhufuni, Itali

në (2013), dhe bustin e Charles Telford Erickson në Golem, Kavajë. Botimet e tij përfshijnë përkthimet: "Shqipëria e Jugut ose Epiri i Veriut në çështjet Evropiane dhe Ndërkombëtare, 1912-1923" nga Dr. E. P. Stickney, "Shpëtimi në Shqipëri" nga Harvey Sarnier, studimi nga National Geographic Magazine "Shqiptarët, Lisa mbi truallin ilir", "Naltësimi i Iskanderit" nga Benjamin Disraeli, "Shqiptarët, evropianët më të lashtë dhe më të rinj", librat e tij janë "Charles Telford Erickson, Jeta dhe Vepra", "Herman Bernstein, Jeta dhe Vepra" (në anglisht dhe në shqip), "Realitetet Shqiptaro-Britanike", "Ambasador i Pushtetit të Butë". Libri më i fundit që po promovohet është përkthimi "Malet e Gjigantëve". Ai është mbajtës i medaljes Kalorës i Urdhërit të Skënderbeut. Për më shumë informacion ju lutem vizitoni: www.MalBerisha.com.



Dr. David Shankland

Dr. David Shankland është drejtor i Institutit Mbretëror Antropologjik, në Londër. Ai u trajnuar në Antropologji Sociale në Universitetin e Edinburgut, më pas u zhvendos në Cambridge për studimet e doktoraturës, gjatë të cilave kreu punë në terren në Anadoll, duke parë veçanërisht çështjet e ndryshimit shoqëror, politikës dhe fesë. Në 1995, David mori një leksion në Universitetin e Uellsit "Lampeter", më pas u transferua në Universitetin e Bristolit, në 2003. Ai ka luajtur

një rol udhëheqës në shumë institucione antropologjike, duke qenë bashkëorganizator i konferencës së Shoqatës Evropiane të Antropologëve Socialë në Bristol, Kryetar i konferencës ASA "Imagjinatat Antropologjike dhe Arkeologjike: e kaluara, e tashmja dhe e ardhmja", dhe në 2009, president i Seksionit të Antropologjisë dhe Arkeologjisë të Shoqatës Britanike të Shkencës.



Prof. Ass. Dr. Gentiana Kera

Prof. Ass. Dr. Gentiana Kera është historiane, pedagoge dhe profesore e asociuar në Departamentin e Historisë, Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë, Universiteti i Tiranës. Ajo ka mbajtur postin e Zëvendësrektore për Kërkimin Shkencor në Universitetin e Tiranës nga maji i vitit 2018 deri në shtatorin e vitit 2020. Interesat e saj kryesore kërkimore përfshijnë Demografinë dhe Historinë e Familjes, Historinë Sociale dhe Urbane të Evropës Juglindore, si dhe Historinë Bashkëkohore të Shqipërisë.

Prof. Kera ka realizuar kërkime shkencore në projekte të ndryshme në Universitetin e Gracit, Austri, ku edhe ka përfunduar studimet pasuniversitare dhe dokto-rale. Ajo ka qenë e angazhuar në projekte të ndryshme ndërkombëtare, ndër më të fundit në projektin "INFORM - Mbyllja e hendekut ndërmjet institucioneve formale dhe joformale në Ballkan" në kuadër të Horizon 2020 dhe projektin "The Great Leap. Multidisciplinary approaches to health inequalities, 1800-2022" në kuadrin e COST.



Ndrek Gjini

Ndrek Gjini është shkrimtar, antropolog dhe përkthyes. Ai është autor i disa librave të botuar në Shqipëri dhe Irlandë. Gjini banon në Galway të Irlandës prej më shumë se 23 vitesh. Ai është diplomuar në Universitetin e Shkodrës për Gjuhë-Letërsi, në ATU (Atlantic Technological University) në Irlandë për Antropologji, dhe në University of Galway ka marrë Master of Arts në Shkrimtari. Gjini është gjithashtu lektor i jashtëm në University of Galway dhe Managing Editor of The Galway Review.



Fjoralba Ponari

Personalitet mediatic i mirënjohur dhe i dashur për publikun, me përvojë të gjerë si prezantuese televizive, e aftë për tu angazhuar në projekte mediatike me përmajtje dhe ndikim në shoqëri. Me aftësi të forta komunikimi, aftësi e dëshmuar për t'u lidhur me publikun dhe një pasion për punën, unë synoj të frymëzoj dhe edukoj të tjerët përmes platformave të ndryshme televizive dhe jo vetëm.

“Brand ambassador” i disa prej emrave më të njohur të biznesit në vend, si “SIGAL UNIQA Group Austria”, kompania më e madhe e sigurimeve.

“Vizion Plus”, Prezantuese e “Ferma Vip” (Mars 2024 – Aktualisht); - “Top Channel”, Prezantuese e “Portokalli” (Janar 2018 - Dhjetor 2023); - “Top Channel”, Prezantuese e “Më thuaj një dëshirë”; - “Top Channel”, Bashkëprezantuese e “E Diell”; - “Top Channel”, Bashkëprezantuese e “Proçesi Sportiv (Euro 2018)”